



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Lagja "Minatori"

email: bashkiabulqize@hotmail.com

V E N D I M

Nr 49 Date 14/6 /2018

PER DISA SHTESA NE VKB NR.91 DATE 22.12.2017 "PER MIRATIMIN E BUXHETIT
TE BASHKISE PER VITIN 2018".

Mbeshtetur ne Ligjin nr.139/2015, "Per Veteqeverisjen Vendore", Ligjin nr.9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperise, I ndryshuar me ligjin nr.68, date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" ligjit 10296 date 08.07.2010 per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, udhezimit te Ministrise se Financave nr.7 date 28.02.2018 "Per procedurat standarte te pregaditjes se programit buxhetor afat mesem, udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr.6/1, date 28.02.2018 "Per pergatitjen e buxhetit vendor", **Keshilli Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 14.06.2018 pasi diskutoi dhe analizoi ne detaje projektin e paraqitur nga Drejtoria e Finances me 11 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim**

V E N D O S I:

- 1- Te miratoje shtesa per shpenzime operative sipas tabelës nr.1 nga shperndarja e fondeve te trashguara nga viti 2017.
- 2- Te miratoje shtesa per shpenzime per investime sipas tabelës nr.1 nga shperndarja e fondeve te trashguara nga viti 2017.

Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

PER KESHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI
Agim TUCI



KRYETARI
Gazmend KENGA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BULQIZE
DREJTORIA E FINANCES

Bulqizë me 11.1.6 /2018

RELACION

DREJTUAR: Këshillit të Bashkisë Bulqizë

OBJEKTI: “Relacion per miratimin e disa shtesave ne VKB nr.91 date 22.12.2017 “
Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2018”

Shtesa ne VKB nr.91 date 22.12.207 “ Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2018” eshte realizuar bazuar ne ligjin 139/2015“Per Veteqeverisjen Vendore“, te Ligjit nr.9936, date 26.06.2008, ”Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar me ligjin nr. 68, date 27.04.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit 10296, date 08.07.20110 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr.6/1, date 28.02.2018 “ Per pergatitjen e buxheti vendor “.

Ne Bashkine Bulqize gjate vitit 2017 jane trashëguar 58,000,000 leke kryesisht :

- transferta e pakushtezuar 19,000,000 leke
- te ardhurat 39,000,000 leke

Keto fonde ne vkb nr.91 date 22.12.2017 “ Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2018”, nuk jane planifikuar per t’u shpenzuar, keshtu qe nga tranferta e pakushtezuar kemi planifikuar shpenzime per detyrimet e vitit 2017:

- shpenzime operative – 1,863,000 leke
- shpenzime per investime – 7,137,000 leke

Ne shpenzimet per investime perfshihen:

- 5% te objekteve ne vleren 3,137,000 leke
- Sherbime supervizimi ne vleren 3,900,000 leke
- Kolaudim ne vleren 100,000 leke

Gjithashtu kemi planifikuar edhe shpenzime per:

- Blereje fadrome + rimorkjator ne vleren 5,000,000 leke
- Blerje kamion pune ne vleren 5,000,000 leke

Te ardhurat e trashëguara nga viti 2017 te cilat nuk jane planifikuar ne vkb e sipercituar jane kryesisht te ardhura te realizuar nga renta minerare gjate muajit dhjetor te vitit 2017. Nga keto te ardhuar planifikohen te kryhen keto shpenzime:

1. Shpenzime Operative
 - Subvencion ujesjellesi per nderhyrje emergjente Zona D ne vleren 7,000,000 leke
 - Mirmbajtje rrugesh ne vleren 3,000,000 leke
 - Vendime Gjykate ne vleren 3,000,000 leke
2. Shpenzime per Investime
 - Blereje fadrome + rimorkjator ne vleren 5,000,000 leke
 - Bashkefinansim me FZHR ne masen 10% per objektin “ Rikonstruksion i Shkolles 9 – vjeçare “Shefqet Tançi” ne vleren 8,000,000 leke
 - Shtesa ne objektin “Rikonstruksion Unaza perendimore Kraste Faza II, Bashkia Bulqize” ne vleren 1,750,000 leke
 - Shtesa ne objektin “Sistemim Asfaltim Rruga Lagjja”Gjeologu”” ne vleren 12,000,000 leke

Relacion mbi Investimet

1.Rikonstruksion Sholla 9 – vjeçare “Shefqet Tançi”

Situata

Shkolla Shefqet Tanci, ne Lagjen e Re Bulqizë është në shërbimtë 578 nxënësve dhe 52 femijeve para shkollor me 25 klasa. Godina e shkollës ka pësuar demtime në suvatime, mure, dritare, dyer dhe banka. Gjendja në të cilën ndodhet godina është një pengesë serioze përmësim dhënien dhe mësim nxënien. Është vlersuar si prioritet për përmirësimin apo rikonstruksion e plotë.

Qellimi i projekti

Qëllimi i projektit është përmirësimi dhe modernizimi i arsimit, me objektiv

- Krijimin e një mjedisi të përshatshëm për procesin mësimor
- Rritjen e interes të nxënësve për të ndjekur shkollën
- Ndërgjegjësimin e nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e shkollës
- Rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastructures shkollore

Grupet e synuara

Banoret e Lagjes se Re dhe fshatit Vajkal 1 ne Bulqize

Shpenzimet e llogaritura 79,221,542 Lekë

2.Rikonstruksion Unaza perendimore Kraste Faza II, Bashkia Bulqize

Vlera e Investimit: **8 750 000** (Tetemilon e shtateqind e pesedhjetemije) leke me tvsh.

Nr. i perfituesve direkt dhe indirekt: 40 000 banore

Objekti paraqitet ne nje gjendje problematike pasi akoma nuk eshte perfunduar investimi duke gene se eshte dhe faze e II. Ne kete rruge elementet e infrastruktures rrugore, investimi i nisur akoma seshte perfunduar per tu bere nje rruge e kalueshme dhe e leviuar nga banoret dhe mjetet

Ky investim do te mundesoje:

- a. Rehabilitimin dhe vitalizimin e kesaj zone, duke e bere funksionale dhe te frekuentueshme
- b. Krijimi i infrastruktures bashkekohore
- c. Permiresimi i jeteses se banoreve
- d. Nxitja e investimeve nga ana e bizneseve
- e. Sistemimin dhe disiplinimin e ujrave te shiu

Duke u referuar ne VKB nr.91 date 22.12.2017 " Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2018" objekti "Rikonstruksion Unaza Perendimore Kraste Faza II" eshte miratuar ne vleren 7,000,000 (shtatemilion) leke me tvsh, pasi u verifikua objekti ne terren u vu re se ka nevojte per nderhyrje edhe shtresen e stabilizantit t=10 cm dhe shtim te disa zerave per punimet elektrike si ndricuesit LED etj. Keshtu si rrjedhoje e nevojtes se siperpermendur shfaqet domosdoshmeria per te kerkuar diferencat e shumes qe eshte shtuar ne projekt preventiv.

3.Sistemim Asfaltim Rruga Lagjja"Gjeologu"

Vlera e Investimit: 16 000 000 (gjashtembedhjetmilion) leke me tvsh.

Nr. i perfituesve direkt dhe indirekt: 1800 banore

Objekti paraqitet ne nje gjendje problematike edhe jashte cdo parametri teknik urban. Trupi i rruges eshte indertuar me material natyror, paraqitet i demtuar dhe teper i amortizuar, asnjehere nuk jane bere nderhyrje per rikonstruksionin e saj. Kryesisht gjate periudhes vjeshte -dimer, mungesa e shtresave asfaltike ben qe ky segment per shkak te reshjeve ne formen e shiut dhe te debores, kalimi i kembesoreve dhe automjeteve te veshtiresohet setepemi dhe here here behet i pakalueshem per shkak te krijimit te pellgjeve ujembledhese apo ngricave ne periudhen e dimrit.

Ky investim do te mundesoje:

- a. Rehabilitimin dhe vitalizimin e kesaj zone, duke e bere funksionale dhe te frekuentueshme
- b. Krijimi i infrastruktures bashkekohore
- c. Permiresimi i jeteses se banoreve
- d. Sistemimin dhe disiplinimin e kanalizimeve te ujrave te bardha dhe te zeza

Duke u referuar ne VKB nr.91 date 22.12.207 " Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2018" objekti "Sistemim Asfaltim Rruga Rruga Lagjja "Gjeologu" (tek sigurimet shoqerore) eshte miratuar ne vleren 4,000,000 (katermilion) leke me tvsh por ketij objekti i shtojme edhe objektin " Rikonstruksion sistemim-asfaltim i rruges nga qendra shendetesore lagjja "Gjeologu" deri pas ish- kompleksit, Bulqize" me nje diference prej 12,000,000 (dymbedhjet milion) leke me tvsh

Shperndarja e fondeve te trasheguara nga viti 2017

Shtesa per detyrimet e vitit 2017

Tabela 1
ne leke

Program	Emertimi i Programit	Kapitulli	Artikulli	Totali
01110	Aparati	01		
04520	Rruget rurale	01	602	1,075,000
	Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi	01	602	702,000
10910			604	86,000
	Totali i shpenzimeve operative			1,863,000
09120	Arsimi Baze	01		
01110	Aparati	01	231	3,337,000
	Totali i Investimeve		231	3,800,000
	TOTALI			9,000,000

Shtesa

Program	Emertimi i Programit	Kapitulli	Artikulli	Totali
01110	Aparati	05		
	Totali i shpenzimeve operative		602	13,000,000
01110	Aparati	01		
01110	Aparati	05	231	5,000,000
06260	Ndermarrja e sherbimeve Publike	01	231	15,000,000
			231	5,000,000
06260	Ndermarrja e sherbimeve Publike	05	231	3,000,000
09120	Arsimi Baze	05		
	Totali i Investimeve		231	8,000,000
	TOTALI			36,000,000
				49,000,000

Duke besuar ne miratimin e ketij projekt – vendimi, Ju falenderojme per mbeshtetjen dhe bashkepunimin tuaj.

Drejtor Finance
Rustem Biçi

KRYETARI
Melaim Damzi